

VENDIM
Nr. 637, datë 1.10.2014

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËSSË QIRASË ME
TARIFËN SIMBOLIKE 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS,
DHE SHOQËRISË “LIBEREST”, SHPK,PËR PASURINË “AGJENCIA E REZERVAVE
TË SHTETIT DORËZ, KOMUNA QENDËR, LIBRAZHD”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën simbolike 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Liberest” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Agjencia e Rezervave të Shtetit Dorëz, komuna Qendër, Librazhd”, me sipërfaqe të përgjithshme 38 200 (tridhjetë e tetë mijë e dyqind) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama